



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
-KOMISIONI I KONKURENCES-

V E N D I M

Nr. 97 Datë 18.12.2008

Për autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfitimi i kontrollit në shoqërinë Volkswagen AG nga shoqëria Porsche SE

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Perpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.12.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të përftimit të kontrollit në shoqërinë Volkswagen AG nga shoqëria Porsche SE, nëpërmjet blerjes të aksioneve.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Aneksi I-Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit dhe relacionit të Sekretares së përgjithshme mbi rastin e përqendrimit nëpërmjet përfitimit të kontrollit në shoqërinë Volkswagen AG nga shoqëria Porsche SE,

V Ë R E N S E:

I. Transaksioni

1. Porsche është zotëruese e 35.52 për qind të aksioneve në shoqërinë Volkswagen. Me transaksionin e datës 16 Qershor 2008, Porsche ka blerë edhe 4,92% të aksioneve me të drejtë vote në shoqërinë Volkswagen, duke përfutur kontrollin e saj.
2. Njoftimi i përqendrimit me objekt përfitim e kontrollit në shoqërinë Volkswagen AG, në emër të blerësit, shoqërisë Porsche Automobile Holding SE, është njoftuar në emër të blerësit në Autoritetin e Konkurrencës më datë 12 Shtator 2008.
3. Ky transaksioni sjell ndryshime në cilësinë e kontrollit mbi një bazë të vazhdueshme afat gjatë, në kuptim të nenit 10 pika 1, gërma b dhe 10, pika 2 të Ligjit është përqendrim dhe duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Palët pjesëmarrëse në transaksion

4. **Porsche Automobil Holding SE (Porsche SE)**, në cilësinë e blerësit është një shoqëri holding, në pronësi dhe e kontrolluar bashkërisht nga familjet Porsche & Piëch, që funksionon sipas legjislacionit gjerman, me seli në Shtuttgart, Gjermani.
5. Porsche SE zhvillon, prodhon, tregton dhe shet makina, të të gjitha llojeve, veçanërisht automjete të përdorimit sportiv –SUV⁽¹⁾, makina sportive dhe pjesë këmbimi nëpërmjet shoqërive bija të saj: Porsche AG, me qendër në Shtuttgart, Gjermani, dhe Porsche Holding GmbH, me qendër në Salzburg, Austri. Të dyja shoqëritë zotërohen 100% dhe kontrollohen bashkërisht në mënyrë indirekte nga familjet Porsche & Piëch.
6. Në tregun shqiptar, Porsche Holding, është e pranishme me anë të shoqërisë Porsche Albania Shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në vitin 2005 dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli: “Qendra e Biznesit, Sky Tower”, No 6/4, Blv. “Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tiranë”.
7. **Volkswagen AG**, është shoqëri aksionere, me seli në Wolfsburg, pjesë e grupit Volkswagen, që funksionon sipas legjislacionit gjerman. Shoqëria Volkswagen AG është një nga prodhuesit më të mëdhenj në

¹ Interim information on the first ten months of the fiscal year 2007/08, (sports utility vehicles - SUVs)

tregun ndërkombëtar dhe prodhon nëntë marka automjetesh si VW, Audi, Seat, Skoda, Scania, Bentley, Lamborghini dhe Bugatti.

III. Xhiro

8. Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në tregun ndërkombëtar për vitin 2007 është miliard lekë, e ndarë:

Porsche SE : Euro = lekë;

Volkswagen :Euro = lekë.

Xhiro totale në tregun e brendshëm (Shqipëri) për vitin 2007 është Lekë, e ndarë:

➤ **Porsche Albania shpk:** Euro =lekë.

➤ **Volkswagen:** Euro = lekë.

9. Pra, xhiro në tregun e brendshëm dhe në tregun ndërkombëtar plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

IV. Tregu i produktit

10. Në përcaktimin e tregut të produktit Komisioni Evropian ka përcaktuar tregun e prodhimit dhe ofrimit për shitje me shumicë; tregun e shpërndarjes me pakicë të automjeteve duke i grupuar në automjete për pasagjerë, automjete sportive, transporti etj.

11. Në tregun shqiptar palët veprojnë në të njëjtin nivel të tregut atë të importit dhe shitjes së makinave të reja të markave të veçanta.

12. Tregu gjeografik është tregu Republikës së Shqipërisë.

13. Palët në transaksion janë të pranishme në tregun shqiptar në mënyrë direkte dhe indirekte.

Porsche është aktive në tregun e tregimit të automjeteve, direkt nëpërmjet Porsche Holding Albania shpk. në importimin dhe shitjen e automjete të markës Porsche dhe të markave të tjera si Audi, Seat, Skoda, dhe Volkswagen LCV (makina për transport mallrash).

Volkswagen është aktive në tregun e tregimit të automjeteve, indirekt nëpërmjet filialit të tij në Itali, nga i cili shoqëria shqiptare Classic shpk, importon dhe tregon makina të markave VW.

V. Analiza e konkurrencës pas përqendrimit

14. Tregu i importit dhe tregtimit të automjeteve të reja është një treg jo shumë i zhvilluar në Shqipëri, krahasuar me numrin total të automjeteve të importuara. Numri i automjeteve në total të importuara në Shqipëri për vitin 2007 është 27.549 nga të cilat 3599 janë të reja duke zënë pjesën prej 13% të tregut total të automjeteve. Gjithsesi për 6-mujorin e I, të vitit 2008 zënë pjesën prej 18%, mund të themi se kemi një tendencë në rritje për përdorimin e automjeteve të reja.
15. Pjesët e tregut për shoqëritë Porsche dhe Volkswagen për vitin 2007 në tregun e tregtimit të automjeteve të reja, janë respektivisht:
 - 7.7 për qind** për Porsche (në mënyrë direkte nëpërmjet shoqërisë bijë Porsche Albania)
 - 15 për qind** për shoqërinë Classic shpk. (në mënyrë direkte).
16. Sipas llogaritjes së Indeksit Hirshman Herfindal, tregu i tregtimit të automjeteve të reja është mesatarisht i përqendruar si para ashtu edhe pas përqendrimit.
17. Për sa më sipër, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të tregut të makinave, konkurrencën mes markave dhe pjesën e konsiderueshme që zënë në tregun e importit dhe shitjes makinat e përdorura, rezulton se përqendrimi i realizuar nuk krijon probleme për konkurrencën pasi as nuk krijon apo forcon pozitën dominuese për asnjërën nga ndërmarrjet që marrin pjesë në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

VENDOSI:

Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit në shoqërinë Volkswagen AG nga shoqëria Porsche SE.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PERPALI

(_____)
Zv/Kryetar

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E